



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr.47/11

Prishtinë, më 01.02.2012, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontić, Duda Balje, Sali Asllanaj, Latif Gashi, Albana Fetoshi, Xhevdet Neziraj, Hasime Krasniqi, Muhamet Mustafa dhe Hykmete Bajrami.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini dhe Dashurije Canolli.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Ramadan Avdiu zv. Ministër i Financave, Ramadan Islami, Rejhane Zylfijaj nga GIZ, monitorues nga OSCE, KDI.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadërgjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 18.01.2012, 23.01.2012 dhe 25.01.2012;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-197 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar;
I ftuar: Bedri Hamza, Ministër i Financave;
4. Miratimi i planit vjetor të punës së Komisionit për Buxhet dhe Financa për vitin 2012;
5. Shqyrtimi i Projektligjit 04/L-081 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare me Raportin me amendamente të Komisionit Funkcional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale;
6. Caktimi i grupeve punuese për shqyrtimin e projektligjeve:
 - 6.1. Projektligji për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare,
 - 6.2. Projektligji nr. 04/L-101 për fondet pensionale të Kosovës,
 - 6.3. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-204 për tatimin në pronën e paluajtshme,
 - 6.4. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave nr.03/L-109,

6.5. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-161 për tatimin në të ardhurat personale,

6.6. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-162 për tatimin në të ardhurat e korporatave,

6.7. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja, rikujtojë anëtarët e komisionit janë të njoftuar përmes formës elektronike për përfundimin e punës së grupit punues në shqyrtimin e amendamenteve të komisionit funksional për Projektligjin për Transmetuesin Publik, dhe shpërndarjen e raportit me rekomandime, për të cilin jemi dakorduar si komision sapo të përfundojë puna e grupit punues të futet si pikë e rendit të ditës. Prandaj propozoi që të jetë pikë e shtesë e rendit të ditës.

Rendi i ditës miratohet me plotësim: Shqyrtimi i raportit me rekomandime për amendamentet e komisionit funksional për Projektligjin për Transmetimin Publik në Kosovë dhe do të jetë pika e katërt dhe në vazhdim bëhet rirenditja e pikave të rendit të ditës.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 18.01.2012, 23.01.2012 dhe 25.01.2012

Kryetarja, konstatoi se procesverbalet nga mbledhjet e Komisionit dt. 18.01 2012, 23.012012 dhe 25.012012 miratohen pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-197 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar

Kryetarja, theksoi se me këtë projektligj, ndër të tjera është përcaktuar mënyra e përcaktimit për furnizimit të mallrave për personat e tatueshëm, vendi i furnizimit të shërbimit, transporti ndërkombëtar të pasagjerëve dhe transporti i mallrave. Është bërë rregullimi për zbritjen e TVSH-së së zbritshme dhe ndryshimet tjera, për të cilat kërkoi sqarime nga sponsoruesi i projektligjit.

Ramadan Avdiu, sqaroi se projektligji është pjesë e strategjisë legislative e qeverisë dhe pjesë e reformave që ka ndërmarr qeveria për zhvillimin e sistemit dhe uljes së kostos për zhvillime sociale dhe zhvill

imin e mediave elektronike si dhe atyre të shkruara në vend. Ky projektligj është edhe në kuadër të objektivave tona për afrimin e legjislacionit tonë me atë të bashkimit evropian. Janë bërë ndryshime për vendin e furnizimit të mallrave për personat e tatueshëm, vendin e furnizimit të shërbimit në transportin ndërkombëtar të pasagjerëve dhe transportin e mallrave të tyre shoqëruese, rregullimet për zbritjen e TVSH-së të zbritshme dhe mallrat nën aranzhimet e posaçme doganore. Po ashtu me këtë projektligj kemi liruare mediat elektronike të shtypura për furnizimet dhe mallrat e importuara për qëllimet e tyre, gazetat e revistat periodike të universiteteve private dhe shërbimeve spitalore dhe kujdesitë shëndetësore.

Sali Asllanaj, vlerësoi se është për tu përshëndetur iniciativa për lirimet e mediave nga TVSH-ja, për lehtësimet që po iu krijohen mediave, kur dihet se ka qenë edhe një premtim i partisë në pushtet. Ajo që bjen në sy te ky projektligj, por edhe të projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e kodit doganor dhe të akcizave, thirrja në projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për ATK-në, i cili është në procedurë të shqyrtimit në Kuvend, që vlerësojë se nuk ka bazë juridike. Ndërkaq komentet për lirin e TVSH-së për universitetet private janë të pa baza, kur dihet se objektivisht nuk kemi objekte private, por kemi fakultete, kolegje.

Muhamet Mustafa, theksoi se mbështet projektligjin dhe lirimet që janë plainfikuar të bëhen. Megjithatë kam pritur që me këtë projektligj që të rregullohet çështja e liritimit të nga tatimi i paisjeve që përdorim për prodhime për një kohë të caktuar deri në arkëtimin e fitimit. Do të duhej të përcaktohej që vlera e paisjeve dhe shuma e TVSH-së që duhet të paguhet nga investitori të shtyhet në disa vite. Kjo do të mundësonte lehtësira për importuesit që do të krijonin vende të reja të punës dhe do ta bënte vendin tonë me atraktiv për investime. Unë e di se në këtë moment mundet me pasur probleme, por sa i përket situatës buxhetore nuk humbim asgjë, pasi që arkëtimi i tatimit do të bëhet gradualisht me shitjen e produkteve të prodhuara. Mendojë se shuma mbi 20.000€ e tatueshme duhet të ulet, pasi që mund të ketë paisje edhe për bujqit, ndërmarrjet e vogla e të mesme. Janë këto dy propozime të mia, përndryshe e përkrahu këtë projektligj.

Hykmete Bajrami, vlerësoi se projektligji i TVSH-së nuk po ndryshohet me qëllim që të realizohet ajo që është premtë në pakën e re fiskale. Pyes zv. Ministrin a do të bëhet përshkallëzimi i TVSH-së siç është premtuar për uljen e TVSH-së për produkte elementare për jetë në 7% dhe rritje për produktet tjera në 17%? Një vërejtje tjetër ka të bëjë me gjuhën e dobët të shkrimit të këtij drafti në gjuhën shqipe, ku më është dashur të lexojë versionin anglisht për të kuptuar versionin shqip. Mendoj që kur të vijnë projektligjet në parlamente mos të merremi më shumë me gabime gramatikore e gjuhësore, por duhet të merremi me përmbajtjen. Mbështes propozimet e z. Mustafa për pushim në pagesën e TVSH-së për mjete kapitale dhe të ulet kufiri prej 20.000 euro.

Hasime Krasniqi, vlerësoi për tu përshëndetur iniciativën e qeverisë që përmes këtij projektligji të bëhet liri i mediave dhe paisjet e tyre nga pagesa e TVSH-së. Një pyetje lidhur me zbritje të pragut nga 50.000€ në 30.000€, ndërkaq për shërbimet parashihet ulje në 20.000€, a është fjala për një gabim teknik apo kjo ndryshon. Përndryshe projektligji është në harmoni me legjislacionin e BE-së, nuk ka kosto buxhetore dhe është në interes të qytetarëve dhe biznesit në Kosovë.

Ramadan Avdiu, në përgjigjet e parafolësës, theksoi se jemi në proces të vazhdueshëm për ndryshimin e politikave fiskale dhe po përpiqemi të krijojmë lehtësira për biznesit sa i përket pagesës së TVSH-së dhe deri më tani janë bërë shumë lehtësime, si rasti i pagesës së akcizës për cigare. Sa i përket liritimit të paisjeve kapitale, një pjesë janë të liruara dhe po punohet që të krijohen edhe lehtësira tjera. Sa i përket përshkallëzimit të TVSH-së dhe jemi në fazën e studimit dhe akoma nuk kemi ardhur në përfundim për të nxjerr ndonjë vendim. Sa i përket TVSH-së në shërbime deri më tani shumica e shërbimeve nuk kanë paguar fare. Mbi 20.000€ llogaritet TVSH-ja për shërbime dhe në të njëjtën shumë për kapitalet të cilat futen në pragun e TVSH-së.

Hykmete Bajrami, theksoi se në opinion po thuhet se po ulet pragu i TVSH-së prej 50.000€ në 30.000€ ndërsa në këtë projektligj nuk e kam parë këtë ndryshim, a është e vërtetë se është propozuar ky ndryshim për uljen e pragut të TVSH-së. Ndërkaq sa i përket

lirimit të TVSH-së për media prej informatave që kemi prej ATK-së është thënë se heqet TVSH-ja për mediat në rastin kur ato importojnë letër apo paisje prej vendeve tjera. Si adresoni ju këtë nëse kompanitë mediale furnizohen kompanitë vendore të cilat sipas këtij projektligji nuk thuhet se janë të liruar nga TVSH-së, të cilave po iu bëhet një konkurrencë e padrejtë dhe kjo do t'i shtyjë kompanitë mediale që të furnizohen jashtë kufirit sepse llogaria e furnizimit do të jetë më e lirë.

Lulzim Rafuna, njoftoi se mund të jetë bërë ndonjë gabim teknik, por nuk ulet pragu i TVSH-së.

Latif Gashi, theksoi se në këtë projektligj ajo çka vlerësohet si informacion jo i kompletuar është mungesa e vlerësimit se si ndikon ky projektligj në të hyrat e buxhetit të Kosovës, në këtë kontekst pyetja është sa do të ndikojnë të hyrat e inkasuara nga TVSH-ja në buxhetin e Kosovës.

Ramadan Avdiu, theksoi se mediat lirohen nga TVSH-ja si subjekte për të gjitha mallrat që i blejnë dhe të gjitha shërbimet, përfshirë edhe mediat elektronike dhe të shkruara. Sa i përket blerjes së letrave brenda vendit mund të specifikohet me projektligj, ndërkaq në pyetjen për të hyrat buxhetore, qëllimi kryesorë i ndryshimit të ligjit është harmonizimi me legjislacionin evropian dhe krijimi i lehtësirave për biznese.

Kryetarja, theksoi se projektligji është në Kuvend në procedurë të shqyrtimit dhe do të kemi rastin si komision funksional për të bërë ndryshimet e arsyeshme që të miratojmë një ligj të mirë dhe të zbatueshëm në interes të bizneseve.

Pas diskutimeve, Komisioni me dhjetë 10 (Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontić, Duda Balje, Sali Asllanaj, Latif Gashi, Albana Fetoshi, Xhevdet Neziraj, Hasime Krasniqi, Muhamet Mustafa) një Kundër (Hykmete Bajrami) dhe asnjë Abstenim nxori këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-197 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar.

4. Shqyrtimi i raportit me rekomandime të grupit punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me amendamentet e komisionit funksional për Projektligjin për Transmetuesin Publik në Kosovë

Naser Osmani, njoftoi se grupi punues ka shqyrtuar amendamentet e komisionit funksional dhe ka vlerësuar se është e nevojshme të bëhen disa ndryshime esenciale në amendamentet e komisionit që kanë pasur të bëjnë më ndikimet buxhetore dhe përshtatjes së këtij ligji me ligjet tjera dhe LMFPP. Është propozuar që të bëhet ulja e përqindjes nga reklamat, marketingu dhe publikimet nga 15% në 10% për të respektuar konkurrencën mediale. Është propozuar që të bëhen plotësimet që kanë të bëjnë llogarinë zyrtare të RTK-së që ajo duhet të bëhet në pajtim me rregullat e Kontrollit dhe Menaxhimit Financiar, për pranimin e parasë publike. Ndryshimet në amendamentin 8 që ka të bëjë me nenin 22, është propozuar që financimin i RTK-së të zbritet në 0.7% për periudhën tre vjeçare. Ndryshimet tjera të propozuara për këtë amendament kanë për qëllim të harmonizimit me LMFPP dhe Rregulloren e Kuvendit për shqyrtimin e raportit dhe propozim buxhetit të RTK-së në Kuvend dhe kompetencat funksionale të komisioneve

për këto qështje. Ndërkaq ndryshimet në amendamentin 9 që i referohet nenit 24 kanë për qëllim të përcaktimi të saktë dhe të drejtë të kategorive që do të lirohen nga parapagimi, eliminimin e paqartësive të financimit të RTK-së nga buxheti pas fillimit të realizimit të mjeteve nga parapagimi dhe është propozuar që RTK-ja të lirohet nga ndarja e mjeteve prej 5% nga parapagimi në fondin në Zyrën e Kryeministrit për komunitetet tjera pakicë dhe është propozua që ky fond të plotësohet nga qeveria gjatë ndarjeve të rregullta buxhetore.

Muhamet Mustafa, theksoi se përshëndet punën e grupit punues, por vlerësoj dy çështje të rëndësishme për të analizuar. Çështja e parë ka të bëjë me propozimin për uljen e reklamave, që në njërën anë mund të zvogëlojnë të hyrat vetanake dhe në anën tjetër në rritjen e buxhetit dhe emetimin e programeve edukative në vend të reklamave dhe marketingut. Çështja tjetër ka të bëjë me afatin tre vjeçar të financimit të RTK-së që do të krijonte një komitet të panevojshëm dhe do të duhej që zgjidhja e financimit të bëhej më shpejtë 18-24 muaj.

Naser Osmani, theksoi se ulja e financimit nga marketingu është simbolike edhe mendoj se RTK nuk ish dashur fare të emitojë reklama. Tri vitet e përcaktuara janë maksimumi, por se ligji përcakton se aktiviteti për gjetjen e zgjidhje së qëndrueshme të financimit të fillojë menjëherë pas miratimit të ligjit.

Kryetarja, sqaroi se financimi i RTK-së nga reklamat do të rishikohet nga KPM-ja pas fillimit të parapagimit. Ndërsa sa i përket afatit tre vjeçar të financimit, në neni 24 parashihet se menjëherë pas miratimit të ligjit por jo më vonë se 12 muaj Kuvendi duhet të miratojë taksën e financimit të RTK-së nga parapagimi. Dhe menjëherë pas miratimit të ligjit, Menaxhmenti i RTK-së duhet të zbatojë mekanizmin për mbledhjen e tarifës.

Duda Balje, ashtu siq jemi dakorduar në grupin punues nëse sigurohen mjetet nga buxheti i Kosovës, kjo është më mirë sepse mjetet që vijnë në atë zyre dhe projektet që realizohen, se sa kur mjetet i lëshon RTK kësaj zyre. Nëse mjetet prej buxhetit shkojnë direkt në zyrën e Kryeministrit kjo do të ishte më mirë për ne dhe gjithashtu kjo është pozitive për RTK sepse këto mjete do të mbesin në buxhetin e tyre.

Sali Asllani, theksoi se i ndan shqetësimet e njëjta me z. Mustafa për zvogëlimin e financimit nga reklamat. Duke ditur se ligji parasheh themelimin e kanalit të dytë në gjuhën serbe dhe propozimi për uljen e financimit në 0.7%, kërkojë një sqarim nga zv. Ministri nëse është i mjaftueshme financimi i RTK-së. Meqë kemi të bëjmë me një medium publik, meriton vëmendje dhe privilegj më të veçantë. Duhet gjetur një zgjidhje e arsyeshme e financimit, në mënyrë që RTK mos të dal me kërkesa tjera që kërkon për të financuar projektet dhe obligimet që dalin nga ligji. Çështje tjetër emocionale është lirimi nga parapagimi i kategorive të luftës, ne kemi miratuar ligjin për kategoritë e luftës dhe beneficinet e tyre rregullohen me atë ligj dhe nuk duhet që të trajtohen edhe në ligjet tjera.

Pas diskutimeve dhe propozimeve me gjashtë vota Për (Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Duda Balje, Latif Gashi, Xhevdet Neziraj, Hasime Krasniqi, Muhamet Mustafa), një Kundër (Albana Fetoshi) një dy Abstenim (Sali Asllanaj dhe Jelena Bontic) komisioni miratoi rekomandimin e grupit punues për ndryshimin e amendamentit 7 që i referohet ndryshimit të nenit 18 paragrafit 1 të projektligjit.

Latif Gashi, konfirmoj se e vetmja çështja që ka mbetur të vendoset në komision është ajo ë e ngriti raportuesi i grupit punues dhe kemi menduar që RTK të lirohet nga ndarja e mjeteve prej 5% nga parapagimi për fondin në kuadër të Zyrës së Kryeministrit për mediat tjera dhe qeveria duhet të ndajë mjetet në procesin e rregullt buxhetor për të mbuluar këtë fond.

Kryetarja, propozoi që paragrafi 12 i nenit 24 të bëhet siq është propozuar pasi që është një çështje që është paraparë në projektligj dhe ka qenë e paraparë edhe më herët, pasi që edhe nuk i kemi informatat e mjaftueshme për të propozuar një ndryshim të këtillë.

Hykmete Bajrami, theksoi se po i kalojmë shpesh nxitimthi gjërat e rëndësishme që pastaj po shfaqen probleme. Kështu është rasti me buxhetin e RTK-së, kur dihet se RTK ka hyrë në borqe ndaj operatorëve privat, pasi që buxheti i ndarë për vitin 2011, pas tre muajve të parë iu është ndarë më i vogël së i vitit 2010, që ka ndikuar që RTK të hyjë në obligime për të realizuar aktivitetet e planifikuara dhe kontraktuara.

Kryetarja, theksoi se askush nuk bart përgjegjësin në rast se RTK e ka tejkaluar buxhetin e miratuar dhe kjo mund të jetë edhe pjesë e keqmenaxhimit të ka bërë RTK-ja që në fakt do të duhej dhënë llogari për tejkalimin e shpenzimeve. Është dashur që ky medium të realizojë aktivitete në bazë të mundësive buxhetore të lejuara

Xhevdet Neziraj, theksoi se po e sheh se RTK-ja në buxhetin e saj është dashur të planifikon mjete edhe për komunitete tjera, pasi që komunitetet pakicë që falsin vetëm shqip nuk kanë qasje as politika redaktuese. Programet që shfaqen janë në gjuhën serbe, turke e boshnjake. RTK duhet planifikoj nga buxheti i vet për ndarjen e mjeteve për të gjitha komunitet dhe jo të bëhen këso ndarje.

Ramadan Avdiu, vlerësoi se RTK ka buxhet të mjaftueshëm për të operuar dhe gjatë dëgjimeve buxhetore edhe menaxhmenti i RTK-së është pajtuar me ndarjet buxhetore. Mirëpo jo rrallëherë aktivitetet e organizatave buxhetore i diktojnë ndarjet buxhetore dhe ndodh e kundërta ndarjet buxhetore i diktojë aktivitetet. RTK do të duhej të lirohej nga obligimi ndaj mediave tjera, të cilat do të përkrahen nga buxheti i shtetit.

Komisioni me tetë vota Për (Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontić, Duda Balje, Sali Asllanaj, Latif Gashi, Albana Fetoshi, Xhevdet Neziraj, Hasime Krasniqi, Muhamet Mustafa), dy Kundër (Muhamet Mustafa dhe Albana Fetoshi) dhe asnjë Abstenim, miratoi propozimet e grupit punues për ndryshimet në amendamentin 8 që i referohen ndryshimeve në nenit 22. paragrafit 4 të projektligjit, ndërkaq ndryshimet tjera të propozuara në nenin 24 u miratuan njëzëri.

Propozimet e grupit punues për ndryshimet në amendamentin 9 që i referohen ndryshimeve në nenin 24, u miratuan, me shtatë vota Për (Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Duda Balje, Latif Gashi, Xhevdet Neziraj, Hasime Krasniqi, Muhamet Mustafa), një Kundër (Albana Fetoshi) dhe dy Abstenime (Jelena Bontić, Sali Asllanaj).

Pas diskutimeve, Komisioni me një Abstenim (Albana Fetoshi) nxori këtë:

REKOMANDIM

1. Projektligji nr. 04/L-46 për transmetimin publik në Kosovë, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.

2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, për Projektligjin nr. 04/L-46 për Transmetuesin Publik në Kosovë, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë, me përjashtim të amendamentit 7 që i referohet ndryshimit të nenit 18 paragrafi 1, amendamentit 8 që i referohet ndryshimeve në nenin 22, paragrafi 2, paragrafi 3, paragrafi 4, nënparagrafi 6.1, nënparagrafi 6.2, nënparagrafi 6.3, nënparagrafi 6.4, nënparagrafi 6.5, dhe amendamentit 9 që i referohet ndryshimeve në nenin 24, paragrafi 2, paragrafi 3, paragrafi 5 dhe paragrafi 12.

Komisioni për Buxhet dhe Financa rekomandon që të bëhen ndryshimet si në vijim:

Amendamenti 7 që i referohet ndryshimit të nenit 18, në paragrafin 1 shifra “15%”, të zëvendësohet me shifrën “10%”

Amendamenti 8 që i referohet ndryshimit të nenit 22, paragrafi 2 të riformulohet si në vijim:

2. Fondet e RTK-së, duke përfshirë parapagimin për transmetuesin publik dhe burimet tjera të financimit të parapara me këtë nen, si para publike, depozitohen në një llogari të vetme zyrtare bankare në pajtim me Rregullat e Kontrollit dhe Menaxhimit Financiar.

Amendamenti 8, që i referohet ndryshimit të nenit 22, në rreshtin e dytë të paragrafit 3, pas fjalës “zyrtare”, të shtohet teksti “**në pajtim me paragrafin 2 të nenit 22 të këtij ligji**”

Amendamenti 8 që i referohet ndryshimit të nenit 22, paragrafi 4 të riformulohet si në vijim:

4. Për një periudhë transitore, deri tre vjeçare, deri në sigurimin e financimit nga parapagimi, çdo vit RTK-së i ndahet 0.7 % e të hyrave nga Buxheti i Republikës së Kosovës, duke përjashtuar të hyrat nga proceset e privatizimit, të hyrat e njëhershme për Buxhetin e Republikës së Kosovës dhe të hyrat vetanake të nivelit qendror dhe lokal.

Amendamenti 8 që i referohet ndryshimit të nenit 22, nënparagrafi 6.1 të riformulohet si në vijim:

6.1. RTK-ja i’a dorëzon Kuvendit raportin e saj vjetor të aktiviteteve jo më vonë se 31 mars dhe propozimin e saj për buxhetin e vitit vijues jo më vonë se 30 tetor.

Amendamenti 8 që i referohet ndryshimit të nenit 22, nënparagrafi 6.2 të fshihet.

Amendamenti 8 që i referohet ndryshimit të nenit 22, nënparagrafi 6.3 të fshihet.

Amendamenti 8 që i referohet ndryshimit të nenit 22, nënparagrafi 6.4 të fshihet.

Amendamenti 8 që i referohet ndryshimit të nenit 22, nënparagrafi 6.5 të fshihet.

Amendamenti 9 që i referohet ndryshimit të nenit 24, paragrafi 2 në rreshtin e parë fjalja “Komisionit të Specializuar të Kuvendit për Media”, të zëvendësohet me fjalën “**Kuvendit**”. Si dhe në rreshtin e tretë dhe katërt, fjalja “Komisionit i Specializuar i Kuvendit”, të zëvendësohet me fjalën “**Kuvendi**”.

Amendamenti 9 që i referohet ndryshimit të nenit 24, paragrafi 3, në rreshtin e parë të fshihen fjalët “**Një vit**”, ndërsa në rreshtin e dytë pas fjalëve “Buxheti i Kosovës”, të shtohet teksti “**sipas nenit 22 paragrafi 4**”

Amendamenti 9 që i referohet ndryshimit të nenit 24, në paragrafin 5 fjalët “*të pensioneve të luftës së UÇK*”, të zëvendësohet me tekstin “**invalidët e luftës dhe familjet e dëshmorëve të UÇK-së**”

Amendamenti 9 që i referohet ndryshimit të nenit 24, paragrafi 12 të fshihet.

5. Miratimi i planit vjetor të punës së Komisionit për Buxhet dhe Financa për vitin 2012

Kryetarja, theksoi se në takimin e përbashkët që kemi pasur me GIZ e kemi analizuar draft planin vjetor të punës së Komisionit dhe ka mbetur që ai të plotësohet me disa ndryshime të propozuara, të cilat janë bërë dhe ka mbetur që në këtë takim të bëhet në votim formal.

Komisioni njëzëri nxori këtë:

VENDIM

Miratohet plani vjetor i punës së Komisionit për Buxhet dhe Financa për vitin 2012.

6. Shqyrtimi i Projektligjit 04/L-081 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare me Raportin me amendamente të Komisionit Funkcional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

7. Caktimi i grupeve punuese për shqyrtimin e projektligjeve

Në bazë të propozimeve, Komisioni caktojë grupet punuese si në vijim:

Grupi punues për shqyrtimin e Projektligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, me këtë përbërje: Safete Hadërgjonaj (raportuese), Naser Osmani, Jelena Bontic, Muhamet Mustafa, Sali Asllanaj, Albana Fetoshi dhe Xhevdet Neziraj.

Grupi punues për shqyrtimin e Projektligjit nr. 04/L-101 për fondet pensionale të Kosovës, me këtë përbërje: Naser Osmani (raportues), Latif Gashi, Jelena Bontic dhe Albana Fetoshi.

Grupi punues për shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, me këtë përbërje: Hasime Krasniqi (raportuese), Hykmete Bajrami dhe Duda Balje.

Grupi punues për shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave nr.03/L-109, me këtë përbërje: Jelena Bontic (raportuese), Latif Gashi dhe Sali Asllanaj.

Ndërkaq shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-204 për tatimin në pronën e paluajtshme, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-161 për tatimin në të ardhurat personale dhe Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-162 për tatimin në të ardhurat e korporatave, u vendos që të bëhet direkt në komision.

8. Të ndryshme

8.1. Kryetarja njoftoi se Komisioni për Bujqësi, Pylltari , Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor ka caktuar një takim të përbashkët me Komisionin për Buxhet dhe Financa, për të diskutuar për Projektligjin për Agjencinë e Kosovës për mbrojtjen nga siguria dhe rrezatimi bërthamor, në të cilin takim janë të ftuar të gjithë anëtarët e komisionit.

8.2. Kryetarja njoftoi anëtarët e Komisionit se është e ftuar një takim të thirrur nga nënkomisioni për mandate, imunitete dhe rregullore të punës me kryetarët e komisioneve për të diskutuar për rregulloren e re të punës së Kuvendit dhe kërkoi nga anëtarët nëse kanë propozime apo rekomandime konkrete lidhur me rregulloren të dorëzojnë në administratën e komisionit, që mëpastaj të prezantohen në këtë takim.

8.3. Në pikë të ndryshme u bisedua edhe për Projektligjin për Lojërat e Fatit, përkatësisht eksperti i angazhuar nga GIZ sipas propozimit të komisionit, arsyetoi komentet dhe sugjerimet e tija lidhur me dispozitat e projektligjit dhe propozimet për ndryshimin e neneve të caktuara. Gjithashtu u zhvillua një bashkëbisedim në mes anëtarëve të komisionit dhe ekspertit lidhur me projektligjin, përvojat e shtetit gjerman dhe të shteteve të BE-së në fushën e lojërave të fatit dhe nevojën e ndryshimeve dhe harmonizimit të dispozitave të projektligjit me legjislacionin evropian dhe përshtatjes me rrethanat e vendit.

Mbledhja përfundoi në orën 13:05.

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjonaj